



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. 517

Tiranë 19/6/2025

VENDIM

Nr. 17, datë 19.6.2025

**PËR
NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AUTOMJETIT TIP “VOLKSWAGEN
SHARAN”, ME NUMËR SHASIE “WVWZZZ7NZEV011095”,
ME TARGË “AA642HT”, NËPËRMJET PROCEDURËS SË SHITJES ME
ANKAND TËRËSOR**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “f”, të nenit 53, pika 6, shkronja “b” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 4, të nenit 22, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 3 shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe të nenit 23, pika 1, shkronja “c” të Rregullores nr. 5, datë 30.03.2017 “Për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 3, pika 2, shkronja “b”, nënpika “i” të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, të nenit 18 Rregullores nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të automjetit tip “Volkswagen Sharan”, me numër shasie “WVWZZZ7NZEV011095”, me targë AA642HT, nëpërmjet procedurës së shitjes me ankand tërësor.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për mbikëqyrjen e punës të njëjësive organizative të Agjencisë, për zbatimin e këtij vendimi, dhe informimin e Këshillit Drejtues mbi zbatimin e tij.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

